



Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raport Mujor – Janar 2009

Kryerja e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare ndikon në të drejtat e të pandehurit gjatë gjykimit dhe shkel obligimin e avokatit mbrojtës për të dhënë përkushtimin e duhur

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) është i brengosur se avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare në shumë raste ofrojnë përfaqësim ligjor nën standarde dhe joefektiv për klientët e tyre gjatë rrjedhës së procedurave penale. Kjo mund të shkel ligjin vendor dhe atë ndërkombëtar si dhe obligimin profesional të tyre që të punojnë me përkushtim të duhur. Gjithashtu kjo mund të ketë pasoja serioze në rrjedhën e procedurave penale dhe të ndikojnë drejtpërdrejtë në rezultat të gjykimeve.

Sipas Nenit 6(3)(c) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa), cilido person i akuzuar për vepër penale ka të drejtë në ndihmë ligjore pa pagesë, në qoftë se ai ose ajo nuk kanë mundësi të paguajnë avokatin ndërkaq interesat e së drejtës kërkojnë një gjë të tillë. Pasi që Konventa është e dedikuar që të garantojë të drejtat që janë praktike dhe efektive, jo teorike ose të imagjinuara, autoritetet kanë për detyrë të sigurojnë që ndihma ligjore e ofruar të jetë “efektive”.¹

Ngjashëm, sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, avokati mbrojtës do të caktohet dhe pagesa e tij bëhet nga mjetet e buxhetit në qoftë se kjo gjë është në interes të drejtësisë dhe nëse i pandehuri nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë ligjore.² Nga avokatët mbrojtës pritet që të luajnë rol aktiv në procedurat penale, sidomos gjatë fazës së gjykimit. Kodi i Kosovës mbi Etikën Profesionale të Avokatëve kërkon nga avokatët që ata t’i ushtrojnë detyrat e tyre me zell dhe me përgjegjësi,³ pavarësisht nga ajo se a janë të angazhuar në mënyrë private ose të caktuar nga gjykata.

Megjithatë, monitorimi i procedurave gjyqësore ka zbuluar se avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare shpesh herë dështojnë t’u ofrojnë klientëve të tyre përfaqësim të efektshëm ligjor. Monitorimi i OSBE-së gjatë viteve të kaluara ka gjetur se avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare në përgjithësi janë pasiv, duken të paimentuar, shpesh ofrojnë vetëm një përfaqësim formal dhe në përgjithësi dështojnë të shfrytëzojnë garancitë procedurale të dizajnuara për të mbrojtur të drejtat e klientëve të tyre.⁴

Monitorimi i vazhdueshëm i kryerjes së detyrave të avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare gjatë rrjedhës së procedurave gjyqësore zbulon se ky trend mos-

¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Artico kundër Italisë*, 6694/74, Aktgjykim, 13 maj 1980, paragrafi 33 (*Artico kundër Italisë*).

² Nenit 12(4) dhe 74(1)(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003 (Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

³ Nenit 6 dhe 8, Kodi i Etikës Profesionale të Avokatëve, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë/Priština, 7 korrik 2007 (Kodi i Etikës Profesionale). Në Nenin 1, Kodi i Etikës Profesionale “[c]akton rregullat dhe parimet e sjelljes, të cilat avokatët janë të obliguar t’u përmbahen gjatë praktikës së tyre gjyqësore, për shkak të ruajtjes së ndershmërisë, dinjitetit dhe reputacionit të avokatëve që veprojnë në Kosovë.”

⁴ Shih *Shqyrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Penale të OSBE-së (1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000)*, faqe 53; *Shqyrtimin e Tretë të Sistemit të Drejtësisë Penale të OSBE-së (tetor 2001)*, faqe 28-31; *Shqyrtimin e Gjashtë të Sistemit të Drejtësisë Penale të OSBE-së (prill 2003 – tetor 2004)*, faqet 33 dhe 72.

efikasitet vazhdon të ekzistojë në masë të gjerë. Më tepër alarmuese, në disa raste avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare duket që haptazi dhe në përgjithësi i injorojnë dëshirat dhe interesat e klientëve të tyre.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një të pandehuri të akuzuar për kryerje të vrasjes së rëndë⁵ gjykata i kishte caktuar një avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare. Gjatë një seance dëgjimore për paraburgim me 28 shkurt 2008, avokati mbrojtës ngriti çështjen e sëmundjes së mundshme mendore të të paditurit, por u pajtua me prokurorin se rrethanat dhe rrezikshmëria e veprës penale justifikonin mbajtjen në paraburgim të klientit të tij. Avokati nuk kundërshtoi paraburgimin dhe nuk sugjeroi ndonjë alternativë tjetër që do të përfshinte trajtim mjekësor. Te pandehurit i u desh vet të ndërhyjë se nuk ndjehej mentalisht i sëmurë, dhe parashtrori vërejtje kundër paraburgimit të tij. Paraburgimi ishte vendosur dhe vazhdimisht shtyhej në këtë rast.

Në një tjetër rast pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë/Peć ku përfshihej një i pandehur për kryerje të vrasjes në tentativë,⁶ prokurori publik parashtrroi kërkesë për paraburgim kundër të pandehurit me 19 gusht 2008. Gjatë dëgjimit për paraburgim, avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare u pajtua se ekzistonte nevoja që paraburgimi të shqiptohet kundër klientit të tij. Mbrojtësi nuk sfidoi dëshmitë e prezantuara nga prokurori e as propozimin për paraburgim.

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priština ku përfshiheshin tre të pandehur të akuzuar për pika të shumëfishta të mashtrimit,⁷ gjatë një seance gjyqësore me 18 korrik 2008 një nga të pandehurit deklaroi se avokati i tij mbrojtës, edhe pse i caktuar sipas detyrës zyrtare, kërkoi që ai ta paguajë për shërbimet e ofruara ligjore. Befasisht, këtij pohimi nuk iu kushtua aspak vëmendje.

Përderisa disa avokatë mbrojtës ofrojnë përfaqësim të duhur ligjor si kur angazhohen privatisht ashtu edhe sipas detyrës zyrtare, ka shumë shembuj kur avokatët e caktuar nga gjykata dështojnë t'i ushtrojnë obligimet e tyre profesionale me zellin dhe përgjegjësinë e kërkuar.

Duhet theksuar se vetëm emërimi ose prezenca e avokatit mbrojtës nuk përmbush obligimin ligjor për ofrim të ndihmës ligjore. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka bërë të qartë se Neni 6 i Konventës thërret për “ndihmë” e jo vetëm “emërim”.⁸ Si pasojë, aty ku avokati i shmanget obligimeve të tij/saj ose për ndonjë tjetër arsye dështon të ofrojë përfaqësim efektiv, autoritetet duhet ta ndërrojnë atë ose ta detyrojnë atë t'i përmbush obligimet e tij/saj.⁹

⁵ Neni 147, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003 (Kodi i Përkohshëm Penal).

⁶ *Id.* Neni 146, lidhur me *id.* Nenin 20.

⁷ *Id.* Neni 261.

⁸ *Artico kundër Italisë*, paragrafi 33.

⁹ *Id. Shih po ashtu Kamasinski kundër Austrisë*, 9783/82, Aktgjykim, 19 dhjetor 1989, paragrafi 65.

Andaj, OSBE rekomandon:

- Avokatët mbrojtës duhet të ofrojnë gjithmonë përfaqësim efektiv ligjor për klientët e tyre, pavarësisht se angazhohen nga ata në mënyrë private apo caktohen nga gjykata sipas detyrës zyrtare.
- Autoritetet relevante, kur konfrontohen me ndonjë rast specifik të përfaqësimit joefektiv ligjor, duhet t'i disiplinonjë mbrojtësit dhe ta detyrojnë atë që t'i përmbush obligimet e veta. Në qoftë se kjo nuk është e mundur atëherë ato duhet ta ndërrojnë mbrojtësin.
- Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të sigurojë që avokatët të kryejnë detyrat e tyre profesionale sipas standardeve të caktuara me Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve.

Dështimi i avokatëve për t'i përmbushur obligimet e tyre profesionale ndaj klientëve në çështjet civile shkel Kodin e Etikës Profesionale

Sipas Nenit 8 të Kodit të Etikës Profesionale avokati duhet “[...]që me ndërgjegje t’i plotësojë detyrat, që dalin prej profesionit dhe të ruajë nderin, respektin dhe dinjitetin e avokaturës, gjatë kryerjes së profesionit të tij dhe në jetën private.” Për më tej, Kodi i Etikës Profesionale kërkon që “[...]gjatë kryerjes së profesionit të avokatit, me sjelljet e veta, duhet të përvetësojë dhe forcojë besimin e klientit, të organeve të judikaturës dhe të organeve të tjera para të cilave paraqitet.”¹⁰ Përpos klientëve të tyre avokatët i detyrohen edhe gjykatave, organeve administrative dhe autoriteteve tjera. Andaj, paraqitja e tyre para këtyre autoriteteve, qoftë me shkrim ose personalisht, “[...]duhet të jetë sa më reale, e përmbledhur dhe në masën që nuk shkon në dëm të mbrojtjes së interesit të klientit.”¹¹

Për më shumë, avokatët kanë për detyrë t’i ofrojnë palës “[...]mbrojtje te nevojshme juridike sa më shpejtë që është e mundur si dhe të pamundësojë çdo zvarritje dhe keqpërdorim të drejtave para gjykatave dhe organeve tjera.”¹² Dhe, “[ë]shtë [d]etyrë e avokatit që me kohë dhe me rregull t’i udhëheq lëndët t’i arkivojë shkresat, të mbajë evidencën e rregullt të afateve dhe gjykimeve, ashtu që ai dhe pala të kenë mundësi t’i vërtetojnë të dhënat mbi gjendjen e lëndëve, [...]”¹³

Obligimi profesional i avokatëve për të kryer detyrat e tyre me kujdesin më të madh del nga roli i veçantë që luajnë avokatët në sistemin e drejtësisë dhe si përfaqësues të klientëve të tyre.

“Klientët kërkojnë njohuri speciale, aftësi dhe zell nga avokatët mu për arsyen se ata nuk janë të aftë që vetvetiu të gjejnë rrugën nëpër një sistem kompleks të drejtësisë. Veç kësaj, kompetenca dhe përkushtimi i avokatit janë esenciale për të ngritur besimin e publikut në profesionin ligjor dhe

¹⁰ *Id.* Neni 7.

¹¹ *Id.* Neni 44.

¹² *Id.* Neni 49.

¹³ *Id.* Neni 87.

administrimin e drejtësisë dhe në mirëmbajtjen e standardeve të larta të profesionalizmit në mes të juristëve.”¹⁴

Megjithatë, OSBE ka monitoruar raste në të cilat avokatët kanë qenë neglizhent për të ofruar përfaqësim profesional dhe të përgjegjshëm për klientët e tyre. Për shembull:

Në një seancë dëgjimore të 18 qershor-it 2008 në regjionin e Gjilan/Gnjilane në një rast anulimi të aktvendimit, avokati i paditësit arriti me një orë vonesë pa e lajmëruar paraprakisht gjykatën. Pasi që e pyeti gjyqtari, avokati tha se ai kishte pasur një gjykim tjetër në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë/Priština. Arritja e vonshme në seanca tregon mungesë respekti për gjykatën, zvogëlon besueshmërinë për gjykatën në sytë e publikut, dhe ul nocionin e asaj që avokatët “[...bashkëpunojnë] për të zbatuar ligjin dhe për të mbrojtur të drejtat themelore dhe interesat e qytetarëve.”¹⁵ Veç gjykatave, avokatët duhet që po ashtu t’i njoftojnë klientët nëse do të vonohen për seanca.

Me 12 shtator 2008 në një rast të dhunës familjare në regjionin e Prishtinë/Priština, avokati i palës së mbrojtur nuk ka pritur me klientin e tij nervoz dhe emocional në sallën e gjyqimit që të fillojë seanca e vonuar. Në vend të kësaj, avokati kryente punë të tjera në objektin e gjykatës duke e lënë palën e mbrojtur me, në mes të tjerëve, dhunuesin e pandehur. Avokati e udhëzoi klientin që ta thërret atë kur të fillojë seanca. Kur seanca filloi, gjyqtari refuzoi kërkesën e palës së mbrojtur për ta thirrur avokatin, dhe në procesverbal shënoi se avokati nuk ishte i pranishëm. Avokati dështoi të përmbush përgjegjësinë e vet për të “fituar dhe forcuar besimin e klientit [të tyre] [dhe] besimin e etniteteve ligjore”.¹⁶

Në një rast të anulimit të kontratës në regjionin Pejë/Peć, përfaqësuesi ligjor i të paditurit me një parashtrësë kërkoi shtyrje të seancës me 5 nëntor 2008 dhe pastaj edhe me 3 dhjetor 2008. Paditësi parashtrëi padinë në tetor të 2005-ës dhe më herët ishin shtyrë edhe disa seanca tjera. Edhe pse avokati i të paditurit e arsyetoi kërkesën e tij për shtyrje bazuar në obligimet që kishte në gjykata tjera, duke marrë parasysh gjendjen e vonuar të rastit, avokati duhet të veprojnë me zell për të ju shmangur çfarëdo shtyrjeje tjetër.

Në së paku dy raste të vërtetimit të pronës në regjionin e Gjilan/Gnjilane, përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurit serbë të Kosovës, dështoi që të sfidoi dëshmitë kundërthënëse që ishin prezantuar në mbështetje të padisë që kishte parashtruar paditësi. Gjatë seancës së mbajtur me 6 gusht 2008, paditësi deklaroi se i ati i tij e kishte blerë pronën kontestuese nga një mashkull serb i Kosovës. Përfaqësuesi i përkohshëm dështoi të hulumtojë

¹⁴ Goldstein Bolocan, Maya, “Etika Profesionale Ligjore: Një Perspektivë Krahasuese”, 8 korrik, 2002. CEELI Seri Konceptesh, e qasshme në <http://ssrn.com/abstract=321700>.

¹⁵ Neni 30, Kodi i Etikës Profesionale.

¹⁶ *Id.* Neni 7.

lidhur me ndryshimet e deklaratave. Veç kësaj, në fjalimet përfundimtare të bëra në seancën e fundit me 14 nëntor 2008, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit tha se dëshmitë e prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor vërtetuan se paditësi ishte pronar ligjor i pronës.

Arritja vonë në seanca, kërkesat për shtyrje në rastet edhe ashtu të vonuara, dhe dështimi për të sfiduar dëshmitë e prezantuara që janë në kundërshtim me interesat e klientit, të gjitha qojnë në shkelje të detyrës së avokatit për të ofruar përfaqësim të ndërgjegjshëm për klientët e tyre dhe shkelje të së drejtës së klientit për ta marr përgjigje nga pala kundërshtare.

Në drejtim të këtyre çështjeve, OSBE rekomandon:

- Avokatët duhet të marrin parasysh obligimet e tyre të veçanta si ndaj klientëve ashtu edhe ndaj sistemit ligjor, kur ofrojnë përfaqësim ligjor.
- Avokatët duhet të veprojnë në atë mënyrë që të sigurojnë se klientët e tyre po pranojnë trajtim korrekt dhe efektiv në sistemin e drejtësisë.
- Avokatët duhet ta menaxhojnë kohën e tyre në atë mënyrë që të jenë në gjendje të paraqiten në seanca dhe t'u shmangen kërkesave për shtyrje të tyre.
- Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të promovojë Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve në mesin e avokatëve, gjyqtarëve dhe publikut në përgjithësi.